

D E K R E T
Nr.1406, datë 11.3.1996

PËR ZHDOGANIMIN E AUTOMJETEVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 28, pika 19, të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”

D E K R E T O J:

Neni 1

Personat fizikë e juridikë që deri më datën 1.2.1996 kanë në pronësi automjete, që në Doganë rezultojnë të paparaqitura, brenda datës 15 prill 1996, duhet të kryejnë veprimet e zhdoganimit pranë organeve doganore.

Neni 2

Personat fizikë e juridikë që kanë në pronësi automjetet e përcaktuara në nenin 1, brenda datës 30 prill 1996 duhet të përfundojnë pajisjen me targa të automjeteve dhe me lejet e qarkullimit përkundrejt deklaratës doganore të konfirmuar nga organi doganor.

Neni 3

Për rastet që do të konstatohen se nuk janë kryer veprimet sipas neneve 1 dhe 2 të këtij dekreti, organet kompetente do të veprojnë sipas ligjit nr.7873, datë 16.11.1994 “Për sekuestrimin e mjeteve tokësore, detare, ajrore, me të cilat kryhen vepra penale” dhe sipas ligjit nr.7599, datë 2.9.1992 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”.

Neni 4

Ngarkohet Ministria e Financave dhe Ministria e Brendshme për zbatimin e këtij dekreti.

Neni 5

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS
Sali Berisha